



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGETISE DHE ENERGJITIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

URDHER

Nr 195, date 9.03.2009

**“PER VERIFIKIMIN FILLESTAR DHE PASARDHES TE INSTRUMENTEVE
MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA”**

Ne zbatim te nenit 23, pika 5, te Ligjit Nr.9875, date 14.02.2008 “Per metrologjine” , me propozim te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise, Ministri i Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes:

URDHERON:

1.Verifikimi fillestar i instrumenteve matese ligjerisht te kontrolluara do te kryet ne perputhje me procedurat e paraqitura ne kete Rregullore (pjesa 1) ketu perfshire dhe plotesimit te kerkesave mbi karakteristikat teknike dhe metrologjike te instrumenteve matese ligjerisht te kontrolluara te paraqitura ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave ”Per kerkesat teknike dhe metrologjike per instrumentet matese ligjerisht te kontrolluara.” miratuar me VKM Nr.1351,date 03.10.2008.

2.Çdo instrument matese ligjerisht i kontrolluar qe perdoret brenda territorit shqiptar duhet te kontrollohet sipas afateve te percaktuara ne Aneksin 2.1. Verifikimi pasardhes i instrumenteve matese ligjerisht te kontrolluara do te kryet ne perputhje me proceduren e paraqitur ne kete Rregullore (pjesa 2) ketu te perfshire dhe sipas gabimeve maksimale te lejueshme qe jane percaktuar ne miratimin e tipit ose ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave “Per kerkesat teknike dhe metrologjike per instrumentat matese ligjerisht te kontrolluara” miratuar me VKM Nr.1351,date 03.10.2008.

3. Ky urdher eshte i vlefshem deri ne momentin qe Shqiperia behet anetare me te drejta te plota e Bashkimit European.

4.Ky urdher hyn ne fuqi menjehere

MINISTRI

GENC RULI

RREGULLORE

PJESA 1

“PER PROCEDUREN E VERIFIKIMIT FILLESTAR TE INSTRUMENTEVE MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA”

Masat e Pergjitheshme

Neni 1

Verifikimi fillestar perben ekzaminimin e nje instrumentit mates te ri apo te riparuar dhe konfirmimi i perputhshmerise se tij me tipin e miratuar /ose me kerkesat e Rregullores se Keshillit te Ministrave « Per karakteristikat teknike dhe metrologjike te instrumenteve mates ligjerisht te kontrolluar » miratuar me VKM Nr.1351,date 03.10.2008 (ketej e tutje vetem Rregullore e Keshillit te Ministrave) lidhur me instrumentin mates ne fjale,

Neni 2

Verifikimi fillestar i instrumenteve matese mund te kryet me metoda te tjera ndaj asaj te kontrollit te njesise, ne rastet e specifikuara ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave dhe ne perputhje me procedurat e adoptuara ne kete urdher

Neni 3

Verifikimi fillestar do te kryet nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise dhe ose person juridik i autorizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise

Neni 4

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise, ose personi juridik i autorizuar, kryen verifikimin fillestar te instrumenteve mates qe kane karakteristikat e matjes sipas Rregullores se Keshillit te Ministrave dhe qe kenaqin kerkesat funksionale dhe teknike te ndertimit, te dhena ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave per kete kategori te instrumenteve.

Kerkese per verifikim fillestar

Neni 5

Nje aplikim per verifikim fillestar mund te behet vetem nga prodhuesi ose perfaqesuesi i tij i vendosur ne Shqiperi

Neni 6

Aplikuesi do te dorezoje ne Drejtorine e Pergjithshme te Metrologjise nje kerkese (Aneksi 1.1) perfshire ne kete urdher

Ekzaminimi per verifikim fillestar te instrumenteve matese

Neni 7

Kur nje instrument mates jepet per verifikim fillestar te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ose te personit juridik te autorizuar, ekzaminimi do te percaktoje:

(a) ne se instrumenti i takon asaj kategorie te perjashtuar nga miratimi i tipit te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise dhe ne se eshte keshtu, ne se i ploteson kerkesat funksionale dhe te konstruksionit teknik qe paraqiten ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave lidhur me kete instrument.

(b) ne se instrumenti mates ka marre miratimin e tipit te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise, dhe ne se eshte keshtu, ne se ai eshte ne perputhje me tipin e miratuar dhe me Rregulloren lidhur me kete kategori instrumentesh matese, ne fuqi ne ditet e leshimit te miratimit te tipit te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise

Neni 8

Ekzaminimi i verifikimit fillestar lidhet ne veçanti, ne perputhje me Rregulloren e Keshillit te Ministrave, me

- karakteristikat metrologjike
- gabimet maksimale te lejueshme
- ndertimin, persa ai garanton qe karakteristikat e matjeve nuk perkeqesohen deri ne nje fare shtrirje nen kushtet normale te perdorimit
- prezencen e mbishkrimeve te pershkruara dhe pllakave apo masave per shenjat e verifikimit

Fiksimi i shenjave te verifikimit fillestar ne instrumentet matese

Neni 9

Kur nje instrument mates kalon me sukses verifikimin fillestar ne perputhje me kerkesat e Rregullores te Keshillit te Ministrave dhe sipas kesaj procedure , Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose personi juridik i autorizuar, autorizon vendosjen nga prodhuesi te shenjës se verifikimit fillestar pjesor dhe te plote te pershkruar ne nje Urdher te Drejtorit te Pergjithshem te Metrologjise

Neni 10

Kur verifikimi fillestar nuk kerkohet per nje kategori instrumentesh matese qe plotesojne kerkesat e Rregullores te Keshillit te Ministrave, prodhuesi nen pergjegjesine e tij fikson per instrumentet matese te kesaj kategorie simbolin e veçante te pershkruar ne Urdherin e Drejtorit te Pergjithshem te Metrologjise

Kryerja e verifikimit fillestar

Neni 11

Verifikimi fillestar kryhet ne nje apo me shume faza (zakonisht dy)

Kryerja e verifikimit fillestar me nje faze

Neni 12

Verifikimi fillestar do te kryet ne nje faze ne ato instrumente qe perbejne nje te tere kur dalin nga fabrika, pra ato mund te transferohen ne vendin e instalimit pa patur nevoja qe me pare te çmontohen.

Neni 13

Procedura e verifikimit fillestar me nje faze duhet te siguroje ne veçanti qe instrumenti eshte ne perputhje me miratimin e tipit dhe ne rastet kur eshte i perjashtuar nga miratimi i tipit, ne se eshte ne perputhje me masat e Rregullores se Keshillit te Ministrave

Kryerja e verifikimit fillestar ne dy faza

Neni 14

Verifikimi fillestar do te behet me dy faza per ato instrumente funksionimi korrekt i te cileve varet nga kushtet qe ato instalohen ose perdoren

Vendi i verifikimit fillestar

Neni 15

Ne se Rregullorja e Keshillit te Ministrave nuk specifikon vendin e kryerjes te verifikimit fillestar, verifikimi fillestar me nje faze do te kryet ne vendin qe zgjidhet nga sherbimi metrologjik perkatese.

Neni 16

Instrumentet qe do te verifikohen ne dy faza do te verifikohen nga sherbimi metrologjik kompetent. Faza e fundit e verifikimit do te kryet ne vendin e instalimit. Fazat e tjera do te kryen sipas nenit 12

Neni 17

Ne veçanti kur verifikimi kryet ne vende jashte ambjenteve te sherbimit metrologjik, sherbimi metrologjik mund te kerkoje nga subjekti

-te vere ne dispozicion etalone dhe mjete te tjera materiale dhe personel ndihmes per kryerjen e verifikimit fillestar

- te jape nje kopje te çertifikates se miratimit te tipit te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ose te Institucionit Metrologjik qe e ka miratuar

Tipi dhe vlefshmeria e shenjave te verifikimit fillestar

Neni 18

Tipi i shenjes se verifikimit fillestar do te pershkruhet me Urdher te Drejtorit te Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise

Neni 19

Vlefshmeria e shenjes se verifikimit fillestar te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ose personit juridik te autorizuar do te zgjase deri ne fund te vitit pasardhes pas vitit ne te cilin eshte fiksuar shenja e verifikimit fillestar.

Njohja e verifikimit fillestar te instrumenteve matese qe importohen ne Shqiperi

Neni 20

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise do te njohë (pranojë) verifikimin fillestar te instrumentave matese qe importohen ne Shqiperi ne se plotesohen kerkesat si vijojne:

- a. verifikimi fillestar te jete kryer ne nje shtet antar te EU ose EEA ose qe ka nenshkruar nje mareveshje me EU
- b. tipi i instrumentit mates te jete i miratuar (ne se kerkohet nje gje e tille)
- c. laboratorit qe ka kryer verifikimin fillestar te kete provuar kompetencen e tij (te jete i akredituar per fushen perkatese dhe ne baze te standarti perkates)

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise mund te kerkoje rezultatet e testimit te instrumentit mates . Testimi i instrumentit mates dhe vendosja e shenjave te verifikimit nuk kerkohet.

Aneksi 1.1

Formati i kerkeses per verifikim fillestar

APLIKIM PER VERIFIKIM FILLESTAR

DREJTORISE TE PERGJITSHMETE METROLOGJISE OSE PERSONI JURIDIK I AUTORIZUAR

1. Te dhena te pergjithshme te aplikantit

Emri i Subjektit prodhues apo perfaqsesit te tij ne Shqiperi

Adresa e subjektit aplikues

.....

Nr.regjistrimit te subjektit

.....

Personi i kontaktit

Nr.Tel.....

Nr.Fax.....

E-mail.....

2. Tipi i instrumentit mates per vleresim/verifikim (*)

(*) shenim pjesa Nr.2 e kerkeses varion nga tipi dhe fusha e matjeve qe i perket tipi i instrumentit mates i cili do te vleresohet

PJESA 2

“PER PROCEDUREN E VERIFIKIMIT PASARDHES TE INSTRUMENTVE MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA “

Masat e pergjithshme

Neni 1

Verifikim pasardhes eshte çdo verifikim i instrumenteve mates qe kryet nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose person juridik i autorizuar, pas verifikimit te meparshem dhe qe perfshin :

- verifikimin periodik te detyrueshem
- verifikimin jashte radhe me kerkese
- verifikimin pas riparimit

Neni 2

Verifikimi pasardhes i nje instrumenti mates mund te kryet para se te mbaroje periudha e vlefshmerise te verifikimit te meparshem, ose me kerkese te perdoruesit ose kur verifikimi i tij eshte deklaruar qe nuk eshte me i vlefshem, psh pas riparimit

Neni 3

Verifikimi pasardhes I instrumenteve matese qe kryet periodikisht ne intervale te specifikuara ne perputhje me proceduren e paraqitur ne kete dokument, eshte verifikim periodik i detyrueshem

Intervalet e riverifikimit

Neni 4

Intervalet e rivefikimit te verifikimit periodik te detyrueshem pershkruhen ne Aneksin 2.1 perfshire ne kete procedure, pavaresisht nga fakti nese eshte Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose personi juridik i autorizuar qe kryen verifikimin periodik te detyrueshem

Neni 5

Si Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ashtu dhe personi juridik i autorizuar jane te detyruar te perdorin te njejtet intervale verifikimi per te njejtin instrument .

Neni 6

Ne rastet kur instrumentet matese ne perdorim i neshtrohen verifikimit periodik te detyrueshem dhe kryen vetem nga person juridik i autorizuar, eshte detyrim qe keto intervale te pershkruhen ne Aneksin sipas nenit 4. te ketij dokumenti

Komponentet e verifikimit pasardhes

Neni 7

Ekzaminimi i verifikimit pasardhes ndahet ne tre komponente te dallueshem, metrologjik, teknik dhe administrativ

Neni 8

Elementet me kryesore te ekzaminimit gjate verifikimit pasardhes jane

- karakteristikat metrologjike
- gabimet maksimale te lejueshme
- konstruksioni, ne ato permasa qe te garantoje qe karakteristikat e matjes nuk priren te keqesohen ne kushte normale te perdorimit
- prezenca e mbishkrimeve te pershkruara dhe pllakat apo masat e marra per fiksimin e shenjës së verifikimit pasardhes
- etj

Rregjistri i instrumenteve matese ne perdorim subjekt i kontrollit metrologjik ligjor

Neni 9

Ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise te nxjerre nje urdher per krijimin e regjistrit te evidentimit te kontrolleve te instrumentave matese. Ne kete urdher pershkruhen rregullat e perdorimit, formatin, instruksionet per plotesimin dhe ruajtjen e regjistrit te instrumenteve matese ne perdorim subjekt i kontrollit metrologjik ligjor

Neni 10

Rregjistri i instrumentave matese ne perdorim, subjekt i kontrollit metrologjik ligjor, do te mbahet nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise pavaresisht nga fakti qe eshte Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise apo personi juridik i autorizuar qe kryen verifikimin pasardhes

Neni 11

Eshte detyrim i personit juridik te autorizuar per kryerjen e verifikimit te instrumenteve matese, ti jape Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise te gjithe infomacionin e duhur per te bere te mundur plotesimin e e regjistrit te instrumeneteve matese ne perdorim subjekt i kontrollit metrologjik ligjor

Planifikimi vjetor i verifikimit pasardhes

Neni 12

Bazuar ne situaten korrente te regjistrit te instrumenteve matese ne perdorim subjekt i kontrollit metrologjik, duke perdorur evidencat e dhena nga metrologet e autorizuar apo inspektoret metrologe, per perdoruesit e rinj te instrumenteve matese dhe bazur dhe ne

kerkesat e reja te subjekteve perdorues te instrumenteve matese subjekt i kontrollit metrologjik, Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose personi juridik i autorizuar do te hartojne planin vjetor per verifikimin pasardhes per vitin tjetër ne vazhdim.

Neni 13

Personat juridike te autorizuar per kryerjen e verifikimit do te hartojne planin e tyre vjetor te verifikimit por duhet ti japin Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise informacion te detajuar rreth ketij plani .

Kryerja e verifikimit pasardhes te instrumenteve matese ne premiset e Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ose te personit juridik te autorizuar

Neni 14

Instrumentet matese do te verifikohen ne premiset e Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ose ne premiset e personit juridik te autorizuar .

Neni 15

Transportueshmeria e instrumenteve matese qe i neshetrohen verifikimit dhe instrumenteve te verifikimit mund te diktoje zgjedhjen e vendit te verifikimit pasardhes

Kryerja e verifikimit pasardhes ne vendin e perdorimit te instrumenteve matese

Neni 16

Ne varesi nga rethanat vendi i verifikimit pasardhes mund te jete vendi i perdorimit .Në rastet kur një instrument matës ligjërishit i kontrolluar, për shkak të konstruksionit, është i lidhur me vendin e instalimit; në raste të instrumenteve matëse që, për shkak të konstruksionit të tyre, mund të dëmtohen apo thyhen gjatë transportit ose ne rast te kushteve te papershtateshme te infrastruktures se transportit per ne premiset e Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise ose te personit juridik te autorizuar, verifikimi pasardhes do te kryhet ne vend perdorim.

Neni 17

Subjekti perdorues i instrumenteve matese ne perdorim subjekt te kontrollit metrologjik ligjor duhet te siguroje akses ne vendin e instalimit dhe tek vete instrumenti mates , si dhe te vere ne dispozicion te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ose te personit juridik te autorizuar mjete dhe personel te nevojshem si dhe te mbuloje shpenzimet qe lidhen me verifikimin pasardhes

Verifikimi pasardhes i sistemeve matese

Neni 18

Verifikimi pasardhes i sistemeve matese do te kryet duke perdorur nje nga opsionet:

- verifikimi veç e veç i instrumenteve matese qe perfshihen ne sistemin mates
- verifikimi i sistemit mates si nje i tere

Verifikimi i instrumenteve matese, vleresimi i konformitetit te te cileve behet sipas ligjit te vleresimit te konformitetit

Neni 19

Te gjithë instrumentet matese konformiteti i te cileve vleresohet sipas ligjit Nr.9779, date 16.07.2007 “Per sigurine e pergjithshme, kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit te produkteve jo ushqimore” do ti nenshtrohen te gjitha procedurave te verifikimit pasardhes si te gjithë instrumentet e tjera matese ne perdorim objekt i kontrollit metrologjik ligjor

Tipi dhe vlefshmeria e shenjave te verifikimit pasardhes

Neni 20

Tipet e shenjave te verifikimit pasardhes, pavaresisht se kush e kryen kete verifikim, Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose personi juridik i autorizuar, do te pershkruhen me urdher te Drejtorit te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise “

Neni 21

Te gjithe personat juridike te autorizuar jane te detyruar te perdorin shenjat e verifikimit pasardhes te pershkruara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise

Neni 22

Vlefshmeria e shenjave te verifikimit mbaron kur perfundon intervali i verifikimit pasardhes te pershkruar ne nenin 4 te kesaj procedure.

Aneksi 2.1

Tabela e intervaleve te verifikimit periodik te instrumenteve mates ligjerishtb te kontrolluara

TABELA 1

Nr.	EMERTIMI I INSTRUMENTIT MATES	Afati i detyrueshem per verifikimin periodik ne muaj
MATESIT MATERIALE TE GJATESISE		
1	Matësit e gjatësisë (druri, metalike, shirit etj) që përdoren në tregëti e shërbime	12
TAKSIMETRAT/TAHOGRAFET		
2	Taksimetrat Tahografet	12 24
MASAT E KAPACITETIT TE SHERBIMIT, MASAT VOLUMORE DHE CISTERNAT RRUGORE (AUTOBOTET)		
3	Rezervuarë matës për transport të lëngjeve të prodhimeve ushqimore (qumësht, pije alkolike, uthull etj) - Autobote , vagon çisterna, çisterna - Bucela dhe fuçia prej druri - Bucela dhe fuçia prej metali	24 12 36
4	Autobote, çisterna për transport të produkteve të naftës.	24
5	Përcaktimi i vëllimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të fuçive, kadeve dhe çisternave prej druri për mbajtjen e pijeve alkolike dhe	

	uthullës - Pas verifikimit të parë - Pas çdo verifikimi periodik -	12 36
6	Përcaktimi i vëllimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të fuçive, kadeve dhe çisternave prej materiali jo druri për mbajtjen e naftes dhe produkteve të saj, e lëngjeve të prodhimeve ushqimore (pije alkolike, uthull, qumësht etj) - Pas verifikimit të parë - Pas çdo verifikimi periodik - Shkallëzimi i nivelit të tankerit dhe transmetuesit të nivelit	24 60 24
7	Masa vëllimore prej qelqi (gota , ballon , etj) me një shenjë	1 herë pas prodhimit
8	Masa vëllimore jo prej qelqi	12
9	Masa vëllimore per lende te thata • Per vëllime te vogla • Per vëllime te medha	12 12
GRAMARET (e klases M1.M2.dhe M3)		
10	Gramarë të klasës M1 që përdoren për matjen e mallrave të çmuara, në laboratore, në farmaci etj	12
11	Gramarë të klasës M2 dhe M3 që përdoren për matje kryesisht në sektorët e shërbimeve të tregtisë etj.	12
INSTRUMENTAT JOAUTOMATIK TE PESHIMIT		
12	Peshore elektronike	12
13	Peshore që përdorin gramarë të klasës M1	12
14	Peshore që përdorin gramarë të klasës M2 dhe M3	12
15	Peshore me platformë, automobilistike dhe hekurudhore	12
SISTEME TE MATJES SE SASIVE TE LENGJEVE PERVEC UJIT		
16	Aparate të shpërndarjes të karburanteve per automjete	6
17	Aparate të shpërndarjes se LPG per automjete	6
18	Dozatorë të mbushjes me lëng	6
19	Kontalitra per shperndaresit e medhenj te karburanteve	6
20	Kontalitra te autoboteve te karburanteve	6
PER MATJEN E SASISE TE KALIMIT		
21	Njehsorë të matjes së ujit të ftohtë	60

22	Njehsorë njëfazorë të matjes së energjisë elektrike	96
	dhe ne se partia e te njejtit prodhim del e rregullt shtyhen edhe 60 muaj te tjera verifikimet pasardhese	156
23	Njehsorë tre fazorë të matjes së energjisë elektrike	96
	dhe ne se partia e te njejtit prodhim del i rregullt shtyhen edhe 60 muaj te tjera verifikimet pasardhese	156
ALKOLMETRAT , ALKOLHIDROMETRAT DHE TERMOMETRAT PER PERCAKTIMIN E FORTESISE SE ALKOLIT		
24	Alkolmetra	Nje here pas prodhimit
25	Alkoholhidrometra	Nje here pas prodhimit
26	Termometra per percaktimin e fortesise se alkolit	Nje here pas prodhimit
MAKINAVE TESTUESE NJE AKSIALE TË MATERJALEVE		
28	Makina të provave të materjaleve : - Me ngarkesë statike një aksiale në shtypje dhe tërheqje. - Makina testuese në shtypje për beton	12 12
PER INSTRUMENTAT MATESETE FUSHAVE TE TJERA		
29	Aparatet për kontrollin e presionit të fryerjes së gomave të automjeteve	12
30	Dozatorë të mbushjes me trupa të ngurtë (sheqer, oriz etj)	6
31	Instrumenta te matjes se mases hektoliter (mases standarte te grurit)	24